

Pasqyra e Pozicionit Financiar (aseteve neto të fondit)

Emri i fondit të investimit: WVP TOP INVEST

Kodi i Fondit të Investimit: FI-A1

Emri i Shoqërisë së Administrimit: WVP Fund Management Tirana SH.A.

Për periudhën: 31.03.2018

	Lek	Lek
	31-03-2017	31.03.2018
1. Mjete monetare në arkë dhe llogari rrjedhëse		2,621,311.45
2. Investime (2a+2b+2c+2d)		72,735,271.50
2a. Letra borxhi të blera në emetimin e parë		
2b. Investime me qëllime tregtimi		
2c. Investime të përshtatshme për shitje		
2d. Investime me afat maturimi		
2b. Investime te blera ne treg sekondar		72,735,271.50
2b.1 Investime me qëllime tregtimi		72,735,271.50
2b.2 Investime të përshtatshme për shitje		
2b.3 Investime me afat maturimi		
2c. Depozita (>3 muaj)		
3. Llogari të arkëtueshme		
3a. Debitorë nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Debitorë nga shoqëritë administruese		
3c. Debitorë nga depozitari		
3d. Parapagime		
3e. Debitorë nga interesi I akumuluar		
3f. Debitorë të tjerë		
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE		75,356,582.94
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë		0.00
5. Detyrime nga investimi në depozita, repo etj		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese		12,384.80
7. Detyrime ndaj depozitarit		1,238.49
8. Detyrime për pagesa ndaj kuota mbajtësve		
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera		12,734.71
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I PERGJEGJESIVE		
C (A-B) AKTIVET NETO		75,330,224.94
D Numri i kuotave të fondit të pensionit të emetuara		75,325.0000
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT		1,000.0694

Pasqyra e Fitim / Humbje

Emri i fondit të investimit: WVP TOP INVEST

Kodi i Fondit të Investimit: FI-A1

Emri i Shoqërisë së Administrimit: WVP Fund Management Tirana SH.A.

Për periudhën: 01.01.2018 - 31.03.2018

Nr.		Lek	
		01.01.2017 - 31.03.2017	01.01.2018 - 31.03.2018
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET	2,621,311.45	
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë		
2	Të ardhura nga interesat		
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit		402,468.12
4	Të ardhura nga dividendët		
5	Të ardhura të tjera		0.06
A (1+2+3+4+5)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET		402,468.18
	SHPENZIMET		
6	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë		
7	Diferenca negative të kurseve të këmbimit		
8	Tarifa për shoqërinë administruese		12,384.80
9	Tarifa për depozitarin		1,238.49
10	Shpenzime të tjera		137,319.05
B (6+7+8+9+10)	TOTALI I SHPENZIMEVE		150,942.34
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-		251,525.84
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË		
d1	Fitimi (humbja) e perealizuar nga investimet në letra me vlerë, +/-		155,367.90
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë		-401,668.79
d3	Amortizimi i primit/zbritjes të aktiveve me afat maturimi fiks	75,356,582.94	
d4	Zhvlerësimi i aktiveve	0.00	
D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TE PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NE LETRA ME VLERË, +/-		-246,300.89
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I ASETIVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		5,224.95

Pasqyra e Fluksit te Parave

Emri i fondit te investimit: WVP TOP INVEST

Kodi i Fondit të Investimit: FI-A1

Emri i Shoqërisë së Administrimit: WVP Fund Management Tirana SH.A.

Për periudhën: 31.03.2018

	Lek	Lek
	31-03-2017	31.03.2018
FLUKSI I PARAVE NGA AKTIVITETI		2,621,311.45
Hyrje nga shitja e asetëve financiare me vlerë të drejtë		-72,735,271.50
Dalje për blerjen e asetëve financiare me vlerë të drejtë		
Hyrje nga shitja e asetëve të disponueshme për shitje		
Dalje për blerjen e asetëve të disponueshme për shitje		
Hyrje nga dividendët dhe interesat		
Dalje për pagime interesash		
Hyrje nga investimi në instrumenta borxhi dhe llogari të arkëtueshme		
Dalje për shkak të nga investimit në instrumenta borxhi dhe llogari të arkëtueshme		
Hyrje nga investimi në asete financiare të mbajtura në maturim		
Dalje për investimin në asete financiare të mbajtura në maturim		
Hyrje nga shoqëria administruese		
Dalje për pagimin e tarifave të shoqërisë administruese		12,384.80
Hyrje nga depozitari		
Dalje për pagimin e tarifave të depozitarit		1,238.49
Dalje për kosto transaksionesh		
Dalje për pagim taksash		
Hyrje të tjera nga aktiviteti		681,582.46
Dalje të tjera nga aktiviteti		75,356,582.94
		0
FLUKSI I PARAVE NGA AKTIVITETI I FINANCIMIT		75,325,000.00
Hyrje nga emetimi i kuotave		75,325,000.00
Dalje për shlyerjen e kuotave		
Dalje për pagesat për kuotambajtësit për ndarjen e fitimeve		
Hyrje të tjera nga aktiviteti I financimit		
Dalje të tjera nga aktiviteti I financimit		
EFEKTET E NDRYSHIMIT NË KURSET E KEMBIMIT		
RRITJA (ZBRITJA) NETO NE FLUKSIN E PARAVE		75,325,000.00
GJENDJA E PARAVE NË FILLIM TE PERIUDHES		
GJENDJA E PARAVE NË FUND TE PERIUDHES		75,325,000.00

Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto

Emri i fondit te investimit: WVP TOP INVEST

Kodi i Fondit të Investimit: FI-A1

Emri i Shoqërisë së Administrimit: WVP Fund Management Tirana SH.A.

Për periudhën: 01.01.2018 - 31.03.2018

	01.01.2017 - 31.03.2017	Lek	Lek	01.01.2018 - 31.03.2018
	Data e vitit parardhës	Rritje	Zbritje	Në datën e raportimit në vitin ushtrimor
RRITJA (ZVOGËLIMI) I ASETVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		2,621,311.45		
Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/-	0.00	402,468.17	150,942.34	251,525.83
Totali i fitimeve (humbjeve) të përcaktuara nga investimet në letra me vlerë, +/-	0.00	279,114.28	525,415.18	-246,300.89
Rivlerësimi i asetëve financiarë të vlefshme për shitje	0.00	0.00	0.00	0.00
RRITJA (ZVOGËLIMI) I ASETVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	0.00	681,582.46	676,357.52	5,224.94
Të hyra nga shitja e kuotave	0.00	75,325,000.00	0.00	75,325,000.00
Të dala nga ndryshimi anëtarësisë	0.00	0.00	0.00	0.00
Të dala për shlyerjen e kuotave	0.00	0.00	0.00	0.00
RRITJA (ZVOGËLIMI) TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT E FONDIT, +/-	0.00	75,325,000.00	0.00	75,325,000.00
TOTALI I RITJES (ZVOGËLIMIT) TË ASETVE NETO, +/-	0.00	76,006,582.46	676,357.52	75,330,224.94
Humbjet/ Fitimet e realizuara	0.00	0.00	0.00	0.00
Efektet nga ndryshimi në politikat kontabël	0.00	0.00	0.00	0.00
Korrigjime	0.00	0.00	0.00	0.00
TOTALI I RITJES (ZVOGËLIMIT) TË FITIMIT TË REALIZUAR, +/-	0.00	0.00	0.00	0.00
TOTALI I DETYRIMEVE NE LIDHJE ME BURIMET E ASETVE	0.00	76,006,582.46	676,357.52	75,330,224.94
AKTIVET NETO	0.00	0.00	0.00	0.00
Në fillim të periudhës	0.00	0.00	0.00	0.00
Në fund të periudhës	0.00	0.00	0.00	75,330,224.94
NUMRI I KUOTAVE		75,356,582.94		
Kuota të të emetuara mbi bazën e kontributeve	0.00	0.00	0.00	75,325.0000
Kuota të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të anëtarësisë (-)	0.00	0.00	0.00	0.00
Kuota të tërhequra për shkak të pagesave të kuotave (-)	0.00	0.00	0.00	0.00
NUMRI I KUOTAVE	0.00	0.00	0.00	75,325.0000

Pasqyra e treguesve të veçantë të fondit të investimit

Emri i Fondit të Investimit: WVP TOP INVEST

Kodi i Fondit të Investimit: FI-A1

Emri i Shoqërisë së Administrimit: WVP Fund Management Tirana SH.A.

Për periudhën: 01.01.2018 - 31.03.2018

Pershkrimi	Periudha ushtrimore	31-03-2018	31-03-2017	31-03-2016	31-03-2015
		(n)	(n-1)	(n-2)	(n-3)
Vlera e aktiveve neto		2,621,311.45			
Numri I kuotave te Fondit		75,325.0000			
Vlera neto e aktiveve per kuote		1,000.0694			
	Periudha ushtrimore	31-03-2018	31-03-2017	31-03-2016	31-03-2015
		(n)	(n-1)	(n-2)	(n-3)
Numri I kuotave te Fondit në fillim të periudhës					
Numri I kuotave te Fondit të emetuara		75,325.0000			
Numri I kuotave te Fondit të shlyera					
Numri I kuotave te Fondit në fund të periudhës		75,325.0000			
Raporti ndermjet kosos dhe aktiveve neto mesatare		0.2004			
Raporti ndermjet te ardhurave neto dhe aktiveve neto mesatare/Fitim I paguar per kuote		0.0069			
Raporti I kthimit te aktiveve te fondit		-0.0142			
Vlera më e ulët e vlerës neto të asetëve për kuotë		1,000.0694			
Vlera më e lartë e vlerës neto të asetëve për kuotë		1,000.2117			
Vlera më e ulët e vlerës neto të asetëve		75,330,224.94			
Vlera më e lartë e vlerës neto të asetëve		75,340,949.12			
Personat juridikë, ndërmjetësues në transaksionet me letrat me vlerë që kanë kryer më tepër se 10% të transaksioneve në periudhën aktuale					
Personat juridikë, ndërmjetësues në transaksionet me letrat me vlerë	Vlera e transaksioneve të kryera përmes personave juridikë si përqindje e vlerës totale të të gjitha transaksioneve në periudhën aktuale	Komisionet e paguara tek personat juridikë për ndërmjetësimin si përqindje e vlerës totale të të gjithë transaksioneve të kryera përmes këtyre personave juridikë			
First Financial Brokerage House	100.00%	0.18%			

Shënime për pasqyrat financiare te WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

1. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.10198 datë 10.12.2009 “ Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim nr. 13, datë 3/01/2018, licensoi Shoqërinë WVP Fund Management Tirana sh.a për të kryer veprimtarinë e administrimit të fondeve të investimit.

Gjithashtu, me vendimin nr. 14, datë 31.01.2018 , Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi Fondin e Investimit WVP Top Invest (Kodi F1- A1), nën administrimin e WVP Fund Management Tirana sh.a.

Shoqëria ka në administrim vetëm një Fond Investimi, WVP Top Invest, i cili nuk është entitet ligjor dhe nuk ka personalitet Juridik.

Mbështetur në ligjin nr.10198 datë 10.12.2009 “ Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi gjithashtu First Investment Bank Albania si bankë depozitare e Fondit të Investimit WVP Top Invest . Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit WVP Top Invest.

2. BAZAT E PËRGATITJES

A) Deklarata e Përputhshmërisë

Pasqyrat Financiare janë Përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, (SNRF) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

B) Bazat e Matjes

Këto Pasqyra Financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare për tregëtim, të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes.

C) Monedha funksionale dhe Raportuese

Këto Pasqyra Financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “LEK” e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në Lek.

D) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.

Përgatitja e Pasqyrave Financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të

Shënime për pasqyrat financiare te WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara . Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar për herë të parë nga Fondi duke qënë se është hera e parë e raportimit për Fondin dhe do të aplikohen në mënyrë të qëndrueshme.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

a)Instrumentet Financiarë

i. Njohja

Fondi në fillim njihet huatë, parapagimet dhe detyrimet në datën e krijimit. Të gjitha aktivet e tjera financiare dhe detyrimet njihen së pari në datën e tregtimit, datë në të cilën Fondi bëhet pjesë e palëve kontraktuale të instrumentit.

ii. Klasifikimi

Shih politikat kontabël 3(c),(d),(e), dhe (f)

iii. Ç'rregjistrimi

Fondi çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur i transferon aktivin një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin, rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Çdo interes në aktivet e transferuara që është krijuar apo i mbahet Fondit është njohur si aktiv apo detyrim më vete i ndarë. Fondi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e kontraktuarat kanë mbaruar, janë shlyer, ose anuluar.

iv. Netimi

Aktivitetet financiare dhe detyrimet netohen midis tyre dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm dhe vetëm kur Fondi ka të drejtën ligjore të netojë këto shuma, t'i shlyejë këto shuma ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet janë paraqitur në baza neto vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për përfitimet dhe humbjet e ndodhura nga një grup i ngjashëm transaksionesh si ato në aktivitetin tregues të Fondit.

v. Matja me kosto të amortizuar

Shënime për pasqyrat financiare te WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera në të cilën një aktiv apo detyrim financiar njihet në momentin fillestar, minus pagesat e principalit plus ose minus amortizimin e akumuluar llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë midis shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus ndonjë zbritje për efekt zhvlerësimi.

vi. Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e kotuara të tregut ose në çmimet e agjentëve të shitjes në një treg aktiv. Për të gjithë instrumentet e tjera financiare vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Metodatat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

vii. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare të Fondit janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur një evidencë objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Shoqëria konsideron provë të zhvlerësimit si për një aktiv specifik, ashtu edhe në bazë kolektive. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme janë vlerësuar për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet e konsiderueshme, për të cilat specifikisht nuk ka evidence për zhvlerësim janë vlerësuar bashkë për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por që nuk është identifikuar ende. Aktivet që nuk janë individualisht të konsiderueshme janë trajtuar kolektivisht për zhvlerësim duke grupuar bashkë aktivet financiare (mbajtur me kosto të amortizuar) me karakteristika të ngjashme risku. Një evidencë objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijnë mos pagesat e një debitori, ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Fondi në terma që Fondi nuk do ti konsideronte në tjetër rast, tregues që një debitor hyn në falimentim apo të tjera të dhëna lidhur me një grup aktivesh si ndryshimet e pafavorshme në gjendjen e pagesës së kreditorëve, emetuesve në grup ose në kushtet ekonomike që çojnë në mospagimin në grup.

b) Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

Shënime për pasqyrat financiare te WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

c) Investime letra me vlere me qëllime tregtimi

Letra me vlerë të mbajtura për qëllime tregtimi maten me vlerën e drejtë. Çdo ndryshim i vlerës së tregut njihet në fitim ose humbje sipas përcaktimeve të politikave të kontabël.

d) Llogaritë të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen ne fillim me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar.

e) Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme mbahen me kosto të amortizuar

f) Vlera neto e aktiveve të Fondit

Vlera neto e aktiveve të Fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

g) Të ardhurat nga interest në letra me vlerë

Te ardhurat nga interest rregjistrohen sipas metodës së interesave të përlllogaritura. Fondi ende nuk ka depozita dhe nuk ka te ardhura nga interesat.

h) Fitim/humbjet e realizuara

Fitim/humbjet e realizuara krijohen ne rastin e shitjes së letrave me vlerë me çmim të ndryshëm nga çmimi i blerjes së letrave me vlerë dhe efektet transferohen në pasqyrën e të ardhura/shpenzime në momentin kur ndodhin.

i) Fitim/humbjet e perealizuara

Fitim/humbjet e perealizuara krijohen në rastin e vlerësimit të letrave me vlerën e tregut, i cili mund të jetë i ndryshëm nga çmimi i blerjes së letrave me vlerë. Kur ndodh shitja e letrave me vlerë, vlera e fitim/humbjeve të perealizuara transferohet në fitim/humbje te realizuara.

j) Tarifat e administrimit

Fondi detyrohet ti paguajë Shoqërisë një tarifë prej 2% (ne bazë vjetore) të vlerës Neto te Aktiveve, shpenzim ky për Fondin i cili e përlllogaritë në bazë ditore.

k) Palë të lidhura

Konsiderohen palë të lidhura palët që kanë influencë, kontroll, ndikim në vendimet financiare dhe efekt mbi fitimin apo humbjen, pozitën financiare të Fondit.

4. STRATEGJIA E INVESTIMIT

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit WVP Top Invest mbështetet në ligjin nr 10198 “ Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive ” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij , si edhe në politikën e brendshme të investimit të shoqërisë administruese e miratuar nga Komiteti i Investimit dhe Këshilli i Administrimit i Shoqërisë dhe i publikuar ne Prospektin e WVP Top Invest.

Struktura e planifikuar e portofolit është si vijon:

Lloji i instrumentit	Tregjet	Përqindje nga portofoli
Aksione - Tituj	Shtetet e përmendura në pikat: a), b), dhe c).	Deri më 100%
Fonde investimi		Deri më 50%
Asete depozitare në llogari me para	Republika e Shqipërisë	Deri më 75%

4.1 Investimet e lejuara

Sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të liçencuara sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të liçencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë së 12 muaj;
- instrumente financiare derivative
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumenteve të mësipërm, shoqëria administruese angazhohet se do të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 “Për

Shënime për pasqyrat financiare të WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për menaxhimin e rrezikut.

4.2 Politika e brendshme e investimit e shoqërisë administruese

Objektivi i investimeve të Fondit është realizimi i fitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit, duke investuar në tituj të kompanive të mëdha “Large Caps” në ekonomitë e zhvilluara botërore të cilat janë udhëheqës në industrinë e tyre dhe kanë histori të vazhdueshme rritëse të pagesës së dividendit kundrejt investitorëve.

Mjetet e fondit do të investohen në tituj të emetuesve, të cilët tregtohen në bursat e rregulluara në këto vende::

- a) SHTETET E BASHKIMIT EUROPIAN
- b) SHBA – SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS
- c) ZVICRA dhe SHTETET E TJERA që janë pjesë të INDEKSIT STOXX EUROPE 50

Shoqëria do t'i investojë mjetet e Fondit konform Ligjit për investimet e lejuara, kufizimin e investimeve dhe tejkalimin e kufizimeve për investime të aseteve së Fondit, në llojet e instrumenteve si vijon:

- i. **Aksione** – tituj e transferueshëm të cilat tregtohet në tregjet e rregulluara të shteteve në pikat: a), b), dhe c).
- ii. **Fondet e investimit** – kuota ose aksione të fondit të investimeve të regjistruara në shtetet e mësipërme në pikat: a), b), dhe c).
- iii. **Depozitat** – depozitat nga bankat e autorizuara në Republikën e Shqipërisë, në afat kohor jo më të gjatë se një vit;
- iv. **Mjete monetare dhe ekuivalente (cash)**

Fondi mund të investojë vetëm në fonde investimi tarifa për administrim e të cilëve nuk tejkalon 2% nga vlera neto e aseteve të atij fondi në nivel vjetor. Deri më 100% të vlerës neto të Fondit mund të investohet në tituj / aksione të emetuesve veprimtaria e të cilëve, kryhet në territorin e vendeve të përmendura më lart.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Sipas ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009 “ Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” , Shoqëria administruese duhet të ketë një funksion për administrimin e rrezikut. Në strukturën organizative, Menaxheri i Administrimit të Riskut është përgjegjës për menaxhimin e rreziqeve.

Shënime për pasqyrat financiare te WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontroll dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Shoqëria përmes standardeve dhe procedurave administrative synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrat e tij.

Rreziku i tregut

Është rreziku i luhatshmërisë të çmimit të titujve në treg. Bazuar në strategjinë e investimit të parashikuar në prospektin e WVP Top Invest, asetet e Fondit do të investohen në instrumente financiare, të cilët janë lirisht të tregtueshëm dhe çmimi i të cilave mund të ndryshojë çdo ditë. Ulja e çmimit të titujve mund të sjellë uljen e vlerës së portofolit të Fondit si dhe vlerën e fitimeve të realizuara dhe e kundërta, rritja e çmimit të titujve mund të sjellë rritjen e vlerës së portofolit të Fondit si dhe rritjen e fitimeve nga ai.

Me qëllim mbrojtjen nga rreziku i tregut dhe minimizimin e tij, Shoqëria do të operojë nëpërmjet diversifikimit të portofolit, konform me parimin e shpërndarjes së rrezikut.

Rreziku operacional

Ky është rreziku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njërezore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë paraqet mundësinë se emetuesi i ndonjë titulli të caktuar të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij në momentin kur ato do të duhet të plotësohen. Mos plotësimi i detyrimeve nga ana e emetuesit të titujve do të kishte impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit.

Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që rreziku i kredisë të përjashtohet plotësisht. Shoqëria do të minimizojë këtë rrezik duke mos përfshirë në portofolin e vet tituj borxhesh.

Rreziku i likuiditetit

Ky rrezik lidhet me mundësinë që një aset financiar të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut. Pavarësisht objektivit të Fondit për të krijuar një portofol të

Shënime për pasqyrat financiare te WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

përbërë kryesisht nga tituj që kanë një treg sekondar aktiv, shitja e një titulli të caktuar, në momentin e kërkuar, mund të bëhet problematike.

Shoqëria do të menaxhojë rrezikun e likuiditetit nëpërmjet investimeve në tituj likuidë të tregtuara në bursat me likuiditet të lartë.

Rreziku i Kurseve të Këmbimit

Rreziku nga kurset e këmbimit paraqet një formë të rrezikut i cili paraqitet gjatë ndryshimit të çmimit të një valute në raport me tjetrën. Fondi në portofolin e vet zotëron tituj të vlerësuar në valuta të ndryshme dhe ndryshimet e mundshme të këtyre valutave në raport me valutën e vendit mund të çojnë deri tek rritja ose zvogëlimi i vlerës së kuotave. Këtë rrezik Shoqëria do ta reduktojë me shpërndarjen e portofolit në valuta të huaja të ndryshme, duke tentuar të uli lëvizjet e mëdha të valutave botërore.

Rreziku Rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislacionin tatimor. Vlera e asetëve të Fondit mund të ndikohet negativisht nga: ndryshimet e legjislacionit që rregullon fondet e investimeve, nga ana e autoritetit rregullues, nga shfaqja e pasigurive në vendet ku janë bërë investimet, të tilla si tendencat politike kombetare dhe ndërkombëtare, ndryshime në politikat e qeverisë, ndryshime në legjislacionin tatimor etj.

Rreziku i Inflacionit

I quajtur ndryshe rreziku i fuqisë blerëse, ky është rreziku që ndryshimet në të ardhurat reale të një investitori pasi i ka përshtatur ato me nivelin e inflacionit të jenë negative.

Ky rrezik tregon se norma e inflacionit tejkalon normën e kthimit nga investimi. Si rrjedhim, investitori mund të pësojë realisht humbje edhe pse ai/ajo mund të ketë patur fitim në terma absolutë.

Rreziku i Performancës

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

Shënime për pasqyrat financiare te WVP Top Invest
Për tre mujorin e mbyllur më 31 MARS 2018
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

SHËNIME:

Mjete monetare në arkë dhe llogari rrjedhëse	31.12.2017	31.03.2018
Llogari rrjedhëse FIB	-	2,621,311.45
		<hr/>
		2,621,311.45
Shpenzime te tjera		
Shpenzime Auditi		1,693.48
Shpenzime tarife te supozuar (AMF)		609.01
Komisione transaksioni (Broker)		35,016.56
		<hr/>
		137,319.05